



Rialokim fondesh në zërat e Buxhetit të Shtetit

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Aktit Normativ nr. 6, datë 21.03.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 22.03.2020 kanë miratuar ndryshimet në Buxhetin e Shtetit për vitin 2020 për përballimin dhe manaxhimin e situatës së krijuar nga COVID-19.

Nëpërmjet këtij akti normativ ri-alokohen fondet buxhetore drejt financimit të sektorëve që janë në vijë të parë për përballimin e situatës për financimin e sektorit të mjekësisë për pajisje, medikamente, materiale mjekësore dhe shërbime të tjera në këtë kuadër.

Sipas aktit normativ të mësipërm, ndër të tjera, parashikohet:

- Shtimi i fondit rezervë nga 1.7 miliardë lekë në 9.2 miliardë lekë, i cili do të përdoret nga Këshilli i Ministrave si vijon:
 - 6.5 miliardë lekë si kontigjencë për paketën sociale antiCovid-19;
 - 1 miliardë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave antiCOVID-19; dhe
 - 1.7 miliardë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;
- Ri-alokimi i një fondi prej 2 miliardë lekësh në programin "Mbështetje për shëndetësinë" të Ministrisë së Mbrojtjes, i cili do të përdoret me Vendim të Këshillit të Ministrave për:
 - mbështetjen në shërbimin spitalor civil e ushtarak; dhe
 - shërbimet komunitare, si për shpenzime korrente ashtu edhe kapitale.
- Shtohet buxheti i sigurimeve shëndetësore, ndër të cilat një shumë prej 2.5 miliardë lekësh do të përdoret për shpenzime korrente dhe kapitale si fond për masat antiCOVID-19.
- Rritja e garancisë së qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese me 11 miliardë lekë, të cilat supozohen të alokohen në dispozicion të sektorit privat në formën e garancisë sovrane, për shoqëritë të cilat do të gjenden përballë vështirësive për pagesën e pagave të punonjësve.

Gjithashtu, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 240, datë 21.3.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga covid-2019", një fond prej 46 105 800 (dyzet e gjashtë milionë e njëqind e pesë mijë e tëtëqind) lekësh i është akorduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrimi" për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-2019, në kategorinë e shpenzimeve korrente.



Reallocation of funds between the items of the State Budget

The Council of Ministers, through the Normative Act no. 6, dated 21.03.2020 "On some additions and amendments to the law 88/2019 "On the state budget for year 2020", published in the Official Gazette no. 45, dated 22.03.2020 has approved the amendments in the State Budget for year 2020 to cope and manage the situation created by COVID-19.

Through this normative act are re-allocated budgetary funds towards financing of sectors that are forefront of facing the situation, by financing the medical sector for equipment, medicines, medical materials and other services in this context

Based on the above normative act, among others, is provided:

- Addition of the reserve fund from ALL 1.7 billion to ALL 9.2 billion, that shall be used by the Council of Ministers on the following:
 - ALL 6.5 billion as contingency for social package antiCOVID-19;
 - ALL 1 billion for other emergencies in the context of antiCOVID-19 measures; and
 - ALL 1.7 billion for unpredicted situations of the general governmental units;
- Re-allocation of a fund of ALL 2 billion in the "Support for healthcare" program of the Ministry of Defence that shall be used by a Decision of the Council of Ministers on:
 - the support of the civil and military hospital service; and
 - communitary services, for current and capital expenditure.
- Health insurance budget increased, among which an amount of ALL 2.5 billion will be used for current and capital expenditure as a fund for antiCOVID-19 measures.
- Increase in central government units guarantee to the benefit of third parties by ALL 11 billion, which are supposed to be allocated to the private sector in the form of sovereign guarantee, for companies that will face difficulties in paying their employees' salaries.

Additionally, through the Decision of Council of Ministers No. 240, dated 21.3.2020 "On an addition to fund in the state budget of the year 2020, approved for the Ministry of Health and Social Protection, on measures for the fulfillment of preliminary necessities as a result of COVID-19 outbreak", a fund of 46,105,800 ALL (fourty six million and a hundred and five thousand and eight hundred) has been accorded to the Ministry of Health and Social Protection in the programme "Planification, management and administration" for the measures for the fulfillments of preliminary necessities as a result of COVID-19 outbreak, in the current expenses category.